

AKTI I THEMELIMIT
I SHOOËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“R3D ” Shpk

Neni 1

EMËRTIMI I SHOOËRISË

Shoqëria e emëruar “R3D” sh.p.k, bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është krijuar sot me datë 01.12.2021 nga Ortaku i vetëm themelues:

Redi Kërniqi, shtetas shqiptar, rezidentë në Shqipëri, me banim në Durrës, i datëlindjes 19.01.1994, me numër personal J40119055C.

Neni 2

QËNDRA DHE EMRI I SHOOËRISË

Selia e shoqërisë do të jetë në Durrës, me adresë L.14, Rr.Asti Nushi, Ish - NPV, Nr.2, Shkozet, Durrës.

Me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve mund të hapen seli sekondare, filial apo forma të tjera shoqërishe, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Shoqëria “R3D” shpk do të përdori në treg emërtimin tregtar “R3D”.

Neni 3

KOHËZGJATJA E SHOOËRISË

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë *pakufizim* dhe do të fillojë efektet e saj nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Ofrimin e shërbimeve dhënies me qera të automjeteve, shitblerje automjetesh.

Trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose rimorkio.

Aktivitet në fushën e sigurimeve, agjensi turistike, shitje biletash traqeti, avionit, etj.

Import eksport, tregëti me shumicë dhe pakicë të veshmbathjeve, të artikujve ushqimore, industrial, bujqësore dhe blektorale.

Përpunim, pjekje dhe paketim (ambalazhim) i produkteve ushqimore.

Instalime, riparime dhe shërbime të aparaturave dhe sistemeve të ndryshme elektronike, servise, menaxhim, hostim, programime dhe cdo gjë e lidhur me to e të tjera.

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuota. Vlera nominale e 1 (një) kuote është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Pjesmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

Ortaku themelues Redi Kërniqi, lloji i kontributit është në para me vlerë vlera 100.000 (njëqind mijë) lekë, zotëron 1 (një) kuotë në kapitalin e shoqërisë e cila është 100% në përputhje me kontributin në kapitalin themeltar.

Kuota e zotërimit në kapitalin e shoqërisë është 100% nga ortaku i vetëm i kësaj shoqërie.

Neni 6

Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj, shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, si dhe të punësojë punëtorë e specialist të ndryshëm me kontratë të rregullt pune sipas ligjeve në fuqi.

Neni 7

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË


Administrator i shoqërisë është Redi Kërniqi.

Neni 8

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij akti edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj.
Akti i themelimit u përpilua nga ortakët themelues, në 4 kopje për t'u administruar sipas ligjit

Ortaku themelues

Redi KËRNIQI

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a horizontal stroke at the bottom, positioned below the printed name.